



NJOFTIM PUBLIK NË LIDHJE ME VENDIMIN E MARRË NGA KOMISIONI I PAVARUR AD HOC PËR RENDITJEN PËRFUNDIMTARE TE KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NGA RADHËT E AVOKATËVE

Komisioni i Pavarur Ad-Hoc, në zbatim të vendimit nr. 6 (86-2024-44), datë 23.01.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, në ushtrim të kompetencave të tij të parashikuara në nenin 33, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 1 dhe 7, të nenit 9, të “Rregullores për funksionimin e Komisionit të Pavarur Ad Hoc, për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve”, vijoi procedurën për verifikimin e kriterëve profesionale dhe morale të kandidatit Saimir Kola për pozicionet vakante anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, në institucionin e Avokatit të Popullit, në datë 26.04.2024, ora 14.30, u zhvillua mbledhja e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për vlerësimin e kriterëve profesionale dhe morale të kandidatit. Bazuar në nenet 34 dhe 132, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të kriterëve profesionale dhe morale si dhe caktimit të peshës specifike për këtë kandidat, Komisioni i Pavarur Ad-Hoc shpall listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve, duke filluar nga kandidatët që kanë marrë pikët më të larta si vijon:

RENDITJA E KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NGA AVOKATIA

1. Eris Hysi
2. Përparim Kalo
3. Erind Merkuri
4. Alban Alimema
5. Erind Gërmenji
6. Fatos Lazimi
7. Entela Shehaj (Memishaj)
8. Saimir Vishaj
9. Albana Tushe
10. Albens Tabaku
11. Klodian Gjermeni (Gjermëni, Gjermëni)
12. Artan Reçi

13. Bledar Bajri (Boshnjaku)
14. Saimir Kola

RENDITJA E KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

1. Përparim Kalo
2. Erind Merkuri
3. Alban Alimema
4. Erind Gërmenji
5. Entela Shehaj (Memishaj)
6. Saimir Vishaj
7. Albens Tabaku
8. Artan Reçi
9. Bledar Bajri (Boshnjaku)
10. Saimir Kola

Në përputhje me nenet 35 dhe 133, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Avokati i Popullit, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad-Hoc, do t’i përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit listën përfundimtare me renditjen e emrave të kandidatëve, duke përfshirë në të edhe kandidatin Saimir Kola.

Me përfundimin e kësaj procedure, konsiderohet tashmë e përfunduar puna e Komisionit të pavarur Ad-Hoc në lidhje me procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve.

Informacioni është aksesuar në faqen e Avokatit të Popullit në linkun:

https://www.facebook.com/avokatipopullit/?locale=sq_AL